Rrjeti i OJQ-ve të grave
"QELIZA" - Gjakovë

Integrimi në Bashkimin Europian i Nivelit Lokal

Raport



FRIEDRICH EBERT STIFTUNG

Prishtinë, tetor 2011

Rrjeti i OJQ-ve të grave
"QELIZA" - Gjakovë

Integrimi në Bashkimin Europian i Nivelit Lokal

Raport

Projekt i mbështetur nga:

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG - FES

Zyra në Prishtinë

Përmbajtja

Hyrje 5

Historiku i Marrëdhënieve në mes Kosovës dhe EU-së 7

Historiku i Planit të Veprimit të Partneritetit Europian 11

Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Europian
– Afrimi i Kosovës me BE-në 14

Raportimi i matricës së PVPE-së për Komunat Përfituese 24

Përmbledhje dhe Rekomandime 34

Hyrje

Ky raport përmbledh punën e deritanishme të Rrjetit të OJQ-ve të Grave "Qeliza" në projektin e Integrimi në EU i nivelit Lokal për periudhën Prill - Shtator 2011. Duke qenë se ky është raporti i parë i tillë, përmbajtja e tij kap më gjerë se vetëm monitorimin e implementimit të PVPE-së. Raporti fillon me një diskutim të shkurtër të rrugëtimit të Kosovës në proceset e integrimit evropian dhe procedurave përkatëse.

Përgjatë tërë këtij diskutimi prezantohen edhe qëndrimet e pakta zyrtare të BE-së në lidhje me (mos)përfshirjen e Kosovës në këtë proces bashkë me vendet fqinje, ashtu siç ishte premtuar në Selanik, dhe jepen vlerësime në lidhje me to. Qëllimi është që përmes këtij raporti të ndikohet në ngritjen e transparencës në fushën e integrimit evropian, e në veçanti që publikut t'i paraqitet gjendja reale në lidhje me këtë proces dhe ku qëndron niveli lokal në përmbushjen e standardeve (Komunat përfituese; Gjakova, Deçani, Juniku, Rahoveci dhe Malisheva), i cili konsiderohet të jetë një nga proceset më të rëndësishme që do të shtyjnë përpara përgatitjet për fazat e mëtejme të integrimit europian të Kosovës.

Me të njëjtin qëllim, pjesa tjetër e këtij raporti prezanton gjendjen në Komunat përfituese në sektorët kyçë relevantë për përmbushjen e veprimeve të cilat dalin nga PVPE-ja gjatë periudhës prill – shtator 2011, kryesisht bazuar në Raportet e ndryshme që komunat i prodhojnë për raportim dhe që mbulojnë këtë periudhë kohore. Një pjesë tjetër prezanton një ecuri të masave të ndërmarra nga autoritetet përkatëse, duke filluar nga hartimi, hyrja në fuqi dhe implementimi i PVPE-së. Në pjesën e parafundit prezantohen raportet e komunave në lidhje me arritjet në përmbushjen e veprimeve të PVPE-së dhe struktura ndër-institucionale përgjegjëse për implementimin e tij, për të vijuar me një pasqyrë të progresit të arritur gjatë periudhës raportuese në implementimin e tij. Në pjesën e fundit prezantohen raportet e Komunave në përmbushjen e veprimeve të cilat dalin nga PVPE-ja e vitit 2011. Raporti përfundon me disa rekomandime.

Integrimi në EU i Nivelit Lokal është projekt i Rrjetit të OJQ-ve të Grave "Qeliza", dhe financohet nga Freidrich Erbert Stiftung (FES). Projekti është realizuar nga muaj prill deri në shtator të vitit 2011. Ky projekt synon të rrisë nivelin e përgjegjshmërisë së Qeverisë lokale, më konkretisht të Komunave përfituese në

raportimin e veprimeve të ndërmarrura në kuadër të PVPE-së për vitin 2011, dhe në të njëjtën kohë të vlerësojmë të arriturat e Komunave përfituese në përmbushjen e PVPE-së, transparencën e procesit për shoqërinë kosovare si dhe monitorimin e komponentëve dhe aktiviteteve të PVPE-së.

Historiku i Marrëdhënieve në mes Kosovës dhe BE-së

Diskutim i shkurtër

Në kontekstin e liberalizimit të regjimit Schengen të vizave të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Kroacisë (dhe Kosovës, në atë kohë nën administrimin e UNMIK-ut), dy janë momentet kyçe që i kanë paraprirë këtij procesi. Në nivelin politik, në Samitin e Selanikut të 21 qershorit 2003, BE shpalli përkushtimin e vet politik për t'u ofruar vendeve të Ballkanit Perëndimor perspektivën e liberalizimit të regjimit të vizave. Aty BE përmend reformat në fushat kyçe me qëllim të përmbushjes së kritereve më të rëndësishme: forcimi i shtetit ligjor, lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe migracionit të paligjshëm, dhe forcimi i kapaciteteve administrative në kontrollin kufitar dhe sigurinë e dokumenteve.[1] Më tej, më 18 shtator 2007, ky përkushtim politik përkthehet në marrëdhënie kontraktuale me nënshkrimin e marrëveshjeve për lehtësimin e vizave dhe për riatdhesim në mes të vendeve anëtare të BE-së, në njërën anë, dhe Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Serbisë, dhe Maqedonisë,[2] në anën tjetër. Përmes këtyre marrëveshjeve mundësohet lehtësimi i procedurave për marrjen e vizave Schengen (në veçanti për ato kategori të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor që kanë më së shumti nevojë për të udhëtuar në BE), si dhe vendosen rregullat dhe procedurat për menaxhimin e migrimit legal dhe luftimin e atij ilegal.

Megjithëse deklarata përfundimtare e këtij samiti jepte të nënkuptohej se perspektiva e liberalizimit të vizave vlen për të gjithë qytetarët e Ballkanit Perëndimor pa dallim,[3] kjo as nuk përmendet në dokumentet bilaterale Kosovë – BE në kuadër të Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim-Asociimit[4] deri në vitin 2009, kur Kosova fillon plotësimin e kritereve në mënyrë të njëanshme. Nga ana tjetër, nga ana e Kosovës mungon një presion politik drejtuar BE-së dhe pranisë së saj në Prishtinë, e as që bëhej fjalë për ndonjë aktivitet diplomatik drejtuar shteteve anëtare të BE-së në këtë aspekt. Në fakt, as lobimi nuk duket se do të kishte ndihmuar shumë në një situatë kur institucionet vendore akoma nuk i kishin

1 Samiti BE-Ballkani Perëndimor – Deklaratë, Pika 7, në dispozicion në http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accession_process/how_does_a_country_join_the_eu/sap/thessaloniki_summit_en.htm

2 Nënshkrimi i nëntë marrëveshjeve për lehtësimin e vizave dhe riatdhesim në mes të Komunitetit Evropian dhe Vendeve të Ballkanit Perëndimor nga Nën-Presidenti Franco Frattini dhe Ministri i Brendshëm Portugez, Rui Carlos Pereira, në dispozicion në http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/07/1350&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en#fn1

3 Samiti BE-Ballkani Perëndimor – Deklaratë, Pika 7, në dispozicion në http://ec.europa.eu /enlargement /enlargement_process /accession_process/how_does_a_country_join_the_eu/sap /thessaloniki_summit_en.htm

4 Procesi i Stabilizim-Asociimit, në dispozicion në http://www.delprn.ec.europa.eu/?cid=2,133, Konkluzionet e Dialogut të PSA-së, në dispozicion në http://www.delprn.ec.europa.eu/?cid=2,169

kompetencat e plota në sektorët relevantë për liberalizimin e vizave, e nuk kishin as kapacitet të plotë juridik për të hyrë në marrëdhënie bilaterale me shtetet anëtare të BE-së për lehtësimin e vizave dhe riatdhesim. Pra hapi i parë do të duhej të kishte qenë transferimi i plotë i kompetencave në këto sektorë nga UNMIK-u te institucionet vendore. Kjo do të duhej të ishte pasuar me reformimin e plotë të kornizës ligjore (në veçanti në sektorin e gjyqësorit, i cili akoma pjesërisht funksionon në bazë të ligjeve të periudhës socialiste) dhe të strukturave institucionale (përfshirë funksionalizimin e plotë të strukturave të reformuara), pasuar nga bashkëpunimi efektiv ndër-institucional (si brenda ashtu edhe ndërkombëtar). Marrë në tërësi, pasi që vendimet e tilla të BE-së është e pamundur të zmbrapsen, është e domosdoshme të krijohet besueshmëri e plotë te shtetet anëtare të BE-së se të gjitha hallkat e institucioneve për zbatimin e ligjit të funksionojnë efektshëm, e prandaj nuk mjafton vetëm që institucionet të posedojnë kapacitet të plotë politik dhe juridik për të vepruar, por edhe të dëshmojnë funksionalitet të plotë dhe rezultate për një periudhë afatshkurtër – afatmesme.

Përfundimisht, në Strategjinë e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2007-2008 për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, të nëntorit 2007, KE propozon fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave me secilin vend të Ballkanit Perëndimor, përveç Kosovës. Në këtë dokument në pjesën për Kosovën vetëm përmendet se i mungon një regjim vizash ndaj vendeve të tjera. Pasi përmbledh përparimin e arritur dhe sfidat në zbatimin e marrëveshjeve për lehtësimin e vizave dhe atyre për riatdhesim, kjo komunikatë jep një perspektivë të qartë drejt arritjes të një udhërrëfyes mbi kriteret që duhet përmbushur (rreth 50 syresh), të cilët përfshijnë implementimin e marrëveshjeve të riatdhesimit dhe fusha të tjera kyçe si azili e migrimi, siguria e dokumenteve, menaxhimi i integruar i kufirit, luftimi i krimit të organizuar, bashkëpunimi i efektshëm ndërkombëtar (në veçanti në çështje policore dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar).[5] Pra nënshkrimi i marrëveshjeve për lehtësimin e vizave dhe atyre të riatdhesimit është parakusht i domosdoshëm për fillimin e çfarëdo dialogu formal për liberalizimin e vizave, të bazuar në udhërrëfyes zyrtar, e në vitin 2007 Kosova nuk plotësonte as kushtin themelor për të nënshkruar marrëveshje të tilla me shtetet anëtare të BE-së (pra kapacitetin juridik e atë politik).

Pas miratimit të propozimit të KE-së nga Këshilli Evropian, në janar 2008, në qershor 2008 fillon dialogu për liberalizimin e vizave, bazuar në udhërrëfyes zyrtarë, me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Serbinë, dhe Maqedoninë. Pas kësaj, secili vend i

5 Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin: Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2007 – 2008"), fq. 13, origjinali në dispozicion në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/strategy_paper_en.pdf

prezanton KE-së 'raportin e gatishmërisë' (deri në shtator 2008), gjë që pasohet me raporte të KE-së për vlerësimin e implementimit të udhërrëfyesve (fundi i nëntorit 2008), e kjo pason me një rreth të dytë të 'raporteve të gatishmërisë' (mesi i vitit 2009), pas dërgimit të misioneve vlerësuese (të përbëra nga ekspertë të KE-së dhe të shteteve anëtare të BE-së) në terren. Në deklaratën zyrtare të BE-së, Komisionari për Zgjerim, Olli Rehn, deklaron se arsyeja e mos-përfshirjes së Kosovës kishte të bënte me atë se "Kosova [...] nuk ka qenë pjesë e dialogut të tanishëm të vizave. Për këtë arsye, dhe gjithashtu për shkak të shqetësimeve rreth sigurisë sa i përket lëshimit të dokumenteve të identifikimit dhe atyre të udhëtimit dhe të pasaportave serbe njerëzve që banojnë në Kosovë [...], edhe këta persona do të mbesin nën obligimin për viza. Më lejoni të nënvizoj se ky është vendim thjesht teknik, i mbështetur në shqetësime rreth sigurisë dhe në përputhje të plotë me RKSKB 1244. Prandaj ky është propozim neutral ndaj statusit." [6]

Ndërkohë që vendet fqinje vazhdojnë avancimin drejt vendosjes së regjimit pa viza me BE-në, me propozimin e Sllovenisë për t'u dhënë shtetasve të Malit të Zi, Maqedonisë, Serbisë, Shqipërisë dhe Bosnjës udhëtim pa viza për në zonën Schengen, miratimin e këtij propozimi nga Parlamenti Evropian përmes një opinioni jo-obligues, përmes të cilit gjithashtu kërkon dhënien e udhërrëfyesit Kosovës.

6 Konferencë shtypi e Nën-Presidentit Barrot dhe Komisionarit Rehn rreth liberalizimit të vizave në Ballkanin Perëndimor, origjinali në dispozicion në http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=SPEECH/09/342&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en

Ndodhur para faktit të kryer, shoqëria civile në Kosovë fillon të reagojë ndaj kësaj.[7] U kryen disa studime dhe hulumtime nga organizata relevante vendore e ndërkombëtare, si Forumi 2015, Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI),[8] në të cilat konstatohej se Kosova është një vend i izoluar, madje edhe më i izoluar se Afganistani, pasi që qytetarët e saj kanë të drejtë qarkullimi pa vizë vetëm në pesë shtete të botës.[9] Pati reagime edhe nga politikanë evropianë: sipas deputetes dhe raportueses për Kosovën në Parlamentin Evropian, Ulrike Launacek, "[...] përkundër faktit që Kosova dhe Serbia nuk kanë raporte të mira, ne megjithatë kërkojmë nga këto dy vende që të kenë bashkëpunim më të mirë mes vete në mënyrë që të mund të flasim për një fillim dialogu [...]. Gjithashtu Serbia e ka të pamundur anëtarësimin në BE nëse nuk e pranon faktin e para tri viteve (pavarësinë e Kosovës)."[10] Si një ndër pikat kryesore ku luan një rol te rëndësishëm ne Liberalizimin e Vizave dhe rrugëtimin e Kosovës drejt integrimit në Bashkimin Europian është edhe Plani i Veprimit të Partneritetit Europian.

7 Apeli i Shoqërisë Civile të Kosovës Parlamentarëve të BE-së dhe Liderëve Europian, http://www.iksweb.org/repository/docs/apeli_i_shoqerise_civile_te_kosoves_parlamentareve_te_BE-s_dhe_lidereve_europian.pdf
8 Debati mbi Udhërrëfyesin për Kosovën – Projekti për Listën e Bardhë Schengen, origjinali në dispozicion në http://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=382
9 Izolimi i Kosovës ? Kosova – Afganistani: 5:22, fq 64, http://www.iksweb.org/repository/docs/izolimi_i_kosoves_alb.pdf
10 Intervistë me deputeten e Parlamentit Evropian, Ulrike Launacek, origjinali në dispozicion në http://seetv.blastmedia.eu/story/index/story_id/15481/media_id/33046

Historiku i PVPE-së

Kosova, sikur edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, është pjesë e procesit të integrimit Evropian që nga Samiti i Zagrebit i vitit 2000 kur edhe filloi Procesi i Stabilizim-Asociimit (PSA) për Ballkanin Perëndimor. Ky proces synon stabilizimin dhe tranzicionin e përshpejtuar të ekonomisë së tregut, promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe perspektivën e integrimit në BE. Ky proces u konkretizua më tej në Samitin e Selanikut (qershor 2003) i cili e përfshiu edhe Kosovën në kornizën e Procesit të Stabilizim–Asociimit, kurse për Kosovën në veçanti kjo perspektivë u konkretizua më tej përmes Komunikatës së KE-së 'E ardhmja evropiane për Kosovën', të datës 20 prill 2005, e cila tregon përkushtimin e Bashkimit Evropian për Kosovën.

Për të jetësuar Procesin e Stabilizim-Asociimit në Ballkanin Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, në qershor 2004 Këshilli Evropian miratoi Partneritetin Evropian për Kosovën, si instrumentin e parë që përcakton prioritetet kryesore afatshkurtra dhe afatmesme për tu adresuar nga institucionet e Kosovës drejt arritjes së perspektivës evropiane. Me qëllim të zbatimit të këtyre prioriteteve, në janar 2004 Qeveria e Kosovës miratoi Planin e parë të Veprimit për implementimin e Partneritetit Evropian. Që nga ai vit, ky dokument kryesor strategjik i Republikës së Kosovës për integrim në BE rishikohet çdo vit dhe implementimi i prioriteteve që parasheh është baza kryesore në rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Që nga marsi i vitit 2003 deri në tetor të vitit 2009, instrumenti kryesor për dialog politik në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian në kuadër të kornizës së Procesit të Stabilizim-Asociimit ka qenë "Mekanizmi i Procesit të Stabilizim-Asociimit". Në nëntor 2009, bazuar në Komunikatën e KE-së për Këshillin dhe Parlamentin Evropian "Kosova – Përmbushja e perspektivës Evropiane" ka avancuar procesin përmes lansimit të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA), në kuadër të së cilit brenda një viti mbahet një Takim Plenar, tetë Takime Sektoriale (ose të Nën-komiteteve), si dhe dy takime 'horizontale': Dialogu me Shoqërinë Civile dhe Komiteti i Përbashkët Monitorues (i cili shërben për monitorimin e implementimit të asistencës së BE-së). Përveç kësaj, mes tjerash Komunikata hap rrugën për fillimin e dialogut për liberalizim të vizave, nënshkrimin e një marrëveshjeje tregtare Kosovë – BE, zgjerim të Masave të Pavarura Tregtare dhe avancime në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar.

Në anën tjetër, për të ndihmuar Kosovën në përmbushjen e perspektivës Evropiane, Bashkimi Evropian siguron përkrahje financiare, kryesisht për ndërtimin e institucioneve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre për përafrim me legjislacionin e BE-së Acquis dhe zbatim të standardeve evropiane, por gjithashtu me synim nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik dhe avancimin e integrimit rajonal. BE-ja është donatori më i madh i Kosovës, i cili ndan më shumë resurse për kokë banori në Kosovë sesa në secilin vend të botës.

Kosova ka konfirmuar përkushtimin e saj për procesin e integrimit europian përmes avancimit të mëtejshëm të kornizës institucionale, më e rëndësishmja nga të cilat ka qenë themelimi i Ministrisë së Integrimit Europian. Në këtë drejtim Qeveria e Kosovës gjithashtu ka fuqizuar Zyrat për Integrim Evropian në institucionet e linjës përmes ngritjes së tyre në Departamente si dhe ka funksionalizuar tutje strukturat për integrim europian, me theks të veçantë në Grupet Punuese dhe Komitetin Punues për Integrim Europian. Më tej Qeveria e Kosovës ka arritur të organizojë me sukses aktivitetet në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit dhe monitorimin e rekomandimeve të dala nga ky Dialog. Gjithashtu koordinimi në mes të Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës në fushën e integrimit europian ka shënuar progres të theksuar gjatë vitit 2010.

Në aspekt të implementimit të PVPE 2011, në fushën kritereve politike ndër më të rëndësishmet që duhet të përmendet është progresi i shënuar në sferën e reformës së administratës publike ku është miratuar korniza e re ligjore dhe strategjike, por edhe në kuadër të reformës së sistemit gjyqësor, me theks të veçantë në përfundimin e emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe miratimit të legjislacionit themelor për institucionet kryesore të sistemit gjyqësor. Është shënuar po ashtu progres i mëtutjeshëm në përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale për luftimin e korrupsionit, me theks të veçantë në miratimin e Ligjit për Financimin e Partive Politike dhe Ligjit për Konfliktin e Interesit si dhe themelimin e Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar. Progres i konsiderueshëm është arritur gjithashtu edhe në procesin e decentralizimit me krijimin dhe funksionalizimin edhe të 4 komunave të reja. Në fushën e bashkëpunimit rajonal, edhe pse me sfida e probleme të shumta, Kosova ka vazhduar me pjesëmarrjen e saj në nismat për bashkëpunim rajonal, kurse gjatë këtij viti Kosova ka marrë kryesimin e radhës të CEFTA-së.

Në fushën e kritereve ekonomike, Qeveria e Kosovës ka vazhduar ruajtjen e stabilitetit makroekonomik përmes mbajtjes së politikave fiskale stabile, progresin e mëtutjeshëm në

forcimin e ekonomisë së tregut dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, përfshirë rishikimin e KASH-it dhe miratimin e legjislacionit përkatës në harmoni me rekomandimet e FMN-së. Autoritetet rregullative gjithashtu kanë vazhduar kontributin në krijimin e parakushteve për një treg konkurrues përmes forcimit të mekanizmave rregullativë dhe rritjes së kapitalit human.

Në fushën e standardeve evropiane, përfshirë këtu politikat sektoriale, Kosova ka vazhduar me afrimin e mëtutjeshëm me BE-në përmes harmonizimit të mëtutjeshëm të politikave dhe kornizës ligjore me standardet e BE-së. Në këtë sferë është shumë e rëndësishme të theksohet që Kosova ka shënuar progres të konsiderueshëm në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Me fokus në përmbushjen e kritereve në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave me BE-në, është kompletuar korniza ligjore dhe reformat institucionale të parapara deri më tani në fushën e vizave, kufijve, azilit dhe migrimit, përfshirë kornizën ligjore, të politikave dhe atë institucionale në fushën e riatdhesimit dhe ri-integrimit të personave të riatdhesuar, e cila paraqet një fushë prioritare në këtë sektor. Gjithashtu është shënuar progres në përmirësimin e kornizës ligjore dhe ndërtimin e reformimin institucional në fushën e Policisë dhe me qëllim të luftimit të të gjitha llojeve të krimit, por edhe në atë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Megjithatë Kosova ende vazhdon të ballafaqohet me sfida të shumta në fushat e lartpërmendura dhe ky Plan parasheh veprime konkrete për adresimin e tyre. Në këtë drejtim prioritete të Qeverisë së Kosovës për vitin e ardhshëm, të cilat në të njëjtën kohë janë edhe prioritete të Bashkimit Evropian për Kosovën, janë;

1) Forcimi i Reformës së Administratës Publike,
2) Forcimi i luftës kundër korrupsionit,
3) Lufta kundër krimit të organizuar dhe shpëlarjes së parave,
4) Menaxhimi efikas i parasë publike – avancimi i sistemit të prokurimit publik, fuqizimi i mekanizmave për mbledhjen e të hyrave buxhetore, shpenzimi efektiv i buxhetit,
5) Forcimi i reformës së gjyqësorit
6) Implementimi i Strategjisë për Liberalizimin e Vizave,
7) Negocimi i marrëveshjes tregtare me BE-në dhe zhvillimi i legjislacionit dhe politikave të tregut të brendshëm dhe konkurrencës në harmoni me acquis,
8) Mirëmbajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe pjesëmarrja konstruktive në takimet rajonale,
9) Infrastruktura - energjia dhe transporti,
10) Zhvillimi i sektorit të bujqësisë.

Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Europian – Afrimi i Kosovës me BE-në

Meqenëse Integrimi Europian mbetet prioriteti kryesor i Qeverisë së Kosovës, Plani i Veprimit i Partneritet Evropian është dokumenti kryesor afatmesëm planifikues, i cili ka për qëllim adresimin e sfidave dhe prioriteteve kyçe afatshkurta dhe afatmesme të identifikuara nga Partneriteti Evropian 2008. Përparimi i mëtutjeshëm i vendit do të matet në bazë të zbatimit të prioriteteve kyçe, afatshkurta dhe afatmesme, në kuadër të Partneritetit Europian përmes Raportit të përvitshëm të Progresit nga Komisioni Europian. Në këtë kontekst, PVPE-ja duhet të përdoret për planifikimin e veprimtarisë së përgjithshme të Qeverisë në lidhje me agjendën politike dhe prioritetet e saj, agjendën legjislative të Qeverisë dhe të Kuvendit, nevojat për punësim, ndërtimin institucional dhe trajnimin e personelit si dhe investimet e nevojshme.

Gjithashtu PVPE-ja duhet të përdoret për komunikim të brendshëm të Qeverisë me qëllim të harmonizimit të objektivave, veprimeve dhe afateve brenda saj; për komunikim mes Qeverisë dhe komunitetit afarist dhe partnerëve social si mekanizëm informues dhe paralajmërues për ndryshimet që do të ndodhin dhe të cilat prekin ato; për komunikim me shoqërinë civile si bazë për ndërtimin e partneritetit; dhe për komunikim me publikun e gjerë në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar në çdo kohë për punën e Qeverisë në procesin e integrimit europian.

Plani ndjek strukturën e Partneritetit Europian për Kosovën 2008 si dhe është në pajtim me kriteret e Kopenhagës dhe Madridit dhe përmban tre kapituj kryesor: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane. Në secilin kapitull, varësisht nga progresi i arritur në ato fusha dhe nevojat për përmirësimin e situatës në të ardhmen, janë paraparë veprime të cilat kanë të bëjnë me sigurimin dhe përmirësimin e politikave strategjike dhe legjislacionit, respektivisht harmonizimin e mëtutjeshëm të kornizës ligjore vendore me Acquis, hartimin dhe miratimin e legjislacionit të ri të nevojshëm dhe veprime të cilat fokusohen në implementimin e legjislacionit në fuqi, reformën institucionale, zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, investimet kapitale, etj.

PVPE 2011 ka gjithsej rreth 400 veprime, prej tyre 60 veprime janë paraparë në fushën e kritereve politike, 50 veprime në fushën e kritereve ekonomike dhe 290 për standardet

evropiane. Me qëllim që PVPE-ja të jetë një dokument më i matshëm dhe më praktik, këtë vit janë përcaktuar edhe indikatorët matës në nivel të veprimeve. Meqenëse ky është një element i ri i këtij Plani, shumë i rëndësishëm për matjen e implementimit të PVPE, si hap i parë në këtë drejtim, këtë vit janë përcaktuar vetëm indikatorët e kontributit/inputit (veprimet dhe buxheti) dhe indikatorët e produktit/outputit, për të vazhduar në të ardhmen edhe me përcaktimin e indikatorëve për prioritete, respektivisht indikatorët e rezultatit (outcome) dhe indikatorët e efekteve (impact). Vlen të theksohet se është shënuar progres në përllogaritjen e kostos së PVPE 2011 dhe lidhjen e tij me buxhetin. Kostoja e totale e PVPE 2011 është vlerësuar të jetë rreth 1,284,092,652.57 €, ku 919,389,065.81 € planifikohet të mbulohen nga BKK, 82,977,585.09 € planifikohet të mbulohen nga donatorët, ndërsa 281,726,001.67 € është vlerësuar të jetë mungesa (zbrazëtira).

Duke pasur parasysh rëndësinë prioritare të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian, si një dokument kryesor mbarë qeveritar për integrim evropian, rishikimi i këtij plani ka marrë parasysh prioritetet e Qeverisë dhe programin e saj (draft), draft buxhetin Kornizën Afat-mesme të Shpenzimeve, Strategjitë e ndryshme sektoriale dhe planet e veprimit, rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian dhe rekomandimet e Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit. Sa i përket rekomandimeve dhe sfidave të identifikuara nga Komisioni Evropian, PVPE 2011 merr parasysh dhe adreson sfidat e Raportit të Progresit 2010 dhe rekomandimet e të gjitha takimeve sektoriale dhe takimit plenar të DPSA-së. Me qëllim të monitorimit dhe të adresimit të duhur të rekomandimeve në fjalë, gjatë vitit 2011, pasi të jenë miratuar konkluzionet e çdo takimi të DPSA-së, Qeveria e Kosovës menjëherë do të parasheh veprime konkrete për adresimin e tyre dhe do t'i përfshijë ato në kuadër të sistemit për monitorimin dhe raportimin e PVPE.

Për të ruajtur koherencën e adresimit të prioriteteve të dala nga dokumente të ndryshme të Bashkimit Europian për Kosovën, gjatë rishikimit të PVPE, Qeveria e Kosovës ka paraparë veprime të cilat marrin parasysh të gjitha prioritetet që dalin nga procesi i integrimit evropian. Gjatë procesit të rishikimit, është vërejtur që një numër i prioriteteve, apo pjesë të tyre janë realizuar dhe tani më mund të llogariten si prioritete të vjetruara. Si rezultat në fusha të caktuara janë paraparë veprime të cilat nuk adresojnë drejtpërdrejtë prioritetet e Partneritetit Evropian, por të cilat veprime adresojnë sfida të caktuara që janë identifikuar nga Raporti i Progresit apo Dialogu i Procesit të Stabilizim-Asociimit, të dy këto instrumente shumë të rëndësishme në afrimin e Kosovës drejt Bashkimit Europian. Në këtë aspekt gjithashtu mund të hasen prioritete për të cilat nuk janë paraparë fare veprime për

arsye se ato prioritete tani më janë të realizuara apo të cilat brenda kornizës së përgjithshme të prioriteteve që dalin nga procesi i integrimit evropian të Kosovës janë më pak relevante apo janë adresuar në prioritetet të tjera afatshkurta ose afatmesme. Në këtë aspekt është shumë e rëndësishme të theksohet nevoja e rifreskimit të prioriteteve të Partneritetit Europian me qëllim të ruajtjes së koherencës së prioriteteve të BE-së për Kosovën dhe si rezultat edhe planifikimit më koherent të Kosovës për adresimin e tyre.

Sa i përket monitorimit të implementimit të Planit të Veprimit të Partneritetit Europian, Ministria e Integrimit Evropian gjatë vitit 2010 lansuar dhe funksionalizuar sistemin elektronik për monitorim dhe raportim të PVPE-së. Gjatë vitit 2010 ky sistem është shfrytëzuar për marrjen e raporteve në baza tremujore nga secili institucion i cili ka bartur mbi vete veprime konkrete në kuadër të PVPE 2010. I njëjti sistem do të përdoret edhe gjatë vitit 2011 për monitorimin e implementimit të PVPE i cili gjithashtu do të përdoret edhe për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të dala nga Dialogu i Procesit të Stabilizim Asociimit.

Në këtë aspekt është me rëndësi të theksohet edhe roli i grupeve punuese për integrim europian, të cilat edhe pse me vështirësi të mëdha kanë luajtur rol të rëndësishëm në aspektin e monitorimit, rishikimit dhe miratimit të këtij plani. Për më të tepër, Ministria e Integrimit Europian në bashkëpunim të ngushtë me Projektin e Binjakëzimit të Komisionit Evropian, ka filluar rishikimin funksional të këtyre grupeve. Në funksion të rritjes së punës efektive dhe përmirësimit të performancës së tyre, është hartuar manuali operativ për këto grupe punuese dhe janë mbajtur trajnimet e nevojshme të të gjitha palëve të përfshira në këto grupe për këtë manual. Më tej, gjithashtu shumë shpejt do të bëhet edhe harmonizimi përmbajtjesor i këtyre grupeve me strukturën e takimeve të DPSA-së me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe kontributit të këtyre grupeve punuese në procesin e implementimit të prioriteteve të Bashkimit Europian për Kosovën.

Përshkrimi i Projektit

Rrjeti i OJQ-ve të grave "Qeliza" me qëllim informimit dhe të ngritjes së kapaciteteve të Zyrtarëve Komunal për Integrime Europiane për krijimin e dokumenteve për raportim, ku kërkohet që në baza të kuartaleve të raportohet për të arriturat komunale në procesin e Integrimeve Europiane. Është munduar që të punoj në bashkëpunim me disa ekspert të kësaj fushe, në përgatitjen dhe lehtësimin e punës së tyre për raportimin e PVPE-së për vitin 2011.

Qëllimi i këtij projekti:

Duke pasur parasysh që shumica e politik-bërësve të Kosovës të cilët i japin një prioritet arritjes dhe përmbushjes së standardeve të Bashkimit Europian dhe rrugës sa më të shpejtë të Kosovës deri tek Integrimi i Kosovës në Bashkimin Europian. Rrjeti i OJQ-ve të grave "Qeliza" kanë lansuar një kampanjë informuese për zyrtaret komunal, grupet e ndryshme të interesit dhe qytetarët, për procesin e Integrimeve Europiane dhe për fondet që Kuvendet Komunale mund të absorbojnë.

Aktivitetet e këtij projekti janë të fokusuara në nevojat që komunat kanë dhe në formimin e rekomandimeve që qojnë në përmirësimin e praktikave të cilat janë në pajtim me kërkesat e Unionit Europian që janë të fokusuara për autoritetet lokale. Këto rekomandime do të përfshijnë dizajnimin e masave konkrete për përmbushjen e rekomandimeve në procesin e vendimmarrjes që do të qonte në rrugëtimin e shpejtë të Kosovës drejt integrimit europian ku do të përfitonin të gjithë qytetarët e Kosovës.

Plani i Veprimit i Partneritetit Europian (PVPE) që nga fillimi ka pasur si qëllim që të krijoj struktura adekuate të cilat janë përgjegjëse për procesin e integrimit në EU. PVPE-ja i ka përafërsisht 60 veprime të cilat komunat do të duhej që ti implementojnë në bashkëpunim me institucionet apo Agjensionet Qeveritare, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal etj.

Në këto moment ekziston një nevoje që të intervenohet në fushën e integrimeve europiane dhe të punohet me afër me Komunat e Kosovës në mënyrë që ky proces të implementohet dhe punohet në bazë të afateve kohore të cilat janë të parapara nga PVPE-ja e vitit 2011. Gjithashtu ky projekt ka pasur si qëllim që të formoj një grup punues që është formuar nga përfaqësues të Kuvendeve Komunale, OJQ-ve, komunitetit, mediave, biznesit dhe ekspertëve të ndryshëm të kësaj fushe ku si qëllim kryesor në një faze të hershme është që të rritet vetëdija për procesin e Integrimeve.

Objektivat e projektit:

Krijimi dhe implementimi i një plani aksional lokal.

Informimi dhe rritja e vetëdijes së komunitetit për procesin e integrimeve dhe në mënyrë të veçantë të kjartsohen nevojat e komunave dhe të veprimeve që duhet të ndërmarrin.

Rritja e bashkëpunimit në mes të Kuvendeve Komunale, OJQ-ve, Komunitetit të biznesit, grupeve të ndryshme të interesit në rritjen e njohurive për procesin e integrimeve dhe për ngritjen e kapaciteteve.

Krijimi i një strategjie koherente në avancimin e procesit të integrimeve, duke aplikuar PVPE-në në qeverisjen lokale gjithnjë duke synuar në agjendën e Kosovës për integrim në BE.

Aktivitetet specifike që ka ndërmarrë ky projekt në mënyrë që të mbërrihen të gjitha objektivat e paraqitura

- Kampanja Infromuese për objektivat, aktivitetet në lidhje me implementimin e projektit
- Trajnimi për Zyrtarët Komunal në raportimin e të arriturave të PVPE-së për vitin 2011
- Punëtoria për identifikimin e prioriteteve dhe veprimeve që dalin nga PVPE 2011 për nivelin lokal
- Punëtoria 3 ditore në unifikimin e raporteve Komunale përfituese për raportimin e të arriturave për PVPE-në e vitit 2011

Kampanja informuese

Më datë 05.04.2011 Rrjeti OJQ "Qeliza" në Gjakovë ka mbajtur kampanjën informuese ku i ka njoftuar të pranishmit lidhur me programin e projektit dhe hapat që priten të ndërmerren në fazat e mëtejme të projektit.

Të ftuar dhe pjesëmarrës kanë qenë: Zyrtarët komunal për integrime Evropiane, zyrtarët e zyrave komunale për komunitete dhe kthim të komunave Gjakovë, Rahovec, Deçan, Malishevë dhe Junik, Drejtoria për zhvillim ekonomik Gjakovë dhe Deçan, Drejtoria për Urbanizëm dhe kadastër Gjakovë, Rahovec dhe Malishevë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizata tjera që veprojnë në Komunat përfituese si: CBDC, OSCE, gazeta Koha ditore, TV Syri etj.

Hapjen e kampanjës informuese e ka bërë Vjollca Kuqi koordinatore e projektit "Integrimet e Bashkimit Evropian në nivelin lokal" ku të pranishmit janë njoftuar që ky projekt përkrahët nga Organizata Gjermane Friedrich Ebert Stiftung si dhe fazat e ardhshme të implementimit të projektit të cilat janë:

a. Më datën 15 04 2011 do të organizohet trajnimi një ditorë që do të mbahet në Gjakovë ku të ftuar do të jenë zyrtarët komunal për integrime evropiane, zyrtarët komunal për komunitete dhe kthim, drejtoritë e ndryshme nëpër komuna dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga komunat Gjakovë, Deçan, Malishevë, Rahovec dhe Junik, temat që do të prezantohen janë:

   1. Procesi i Integrimeve Europiane dhe ndërlidhja e Kosovës në këtë proces,
   2. Prezantimi i Planit të Veprimit për Partneritet Europian/ Roli i komunave në këtë proces dhe

3. Roli dhe rëndësia e komunave në procesin e Bashkëpunimit Ndërkomunal në Kosovë.

b. Me datën 20 04 2011 do të organizohet punëtoria një ditore me një grup punues prej 7 deri në 10 zyrtarë nga komunat në fjalë për identifikimin e veprimeve konkrete të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian 2011 që kanë të bëjnë me nivelin lokal – komunat.

c. Gjatë muajve Maj dhe Qershor 2011 do të bëhet monitorimi i komunave Gjakovë, Deçan, Malishevë, Rahovec dhe Junik lidhur me implementimin e veprimeve të PVPE 2011 të identifikuara nga grupi punues si dhe do të vlerësohen arritjet, ngecjet dhe realizimet e tyre nga komunat në fjalë duke u bazuar në afatin kohorë të PVPE 2011 për realizimin e tyre.

d. Raporti i monitorimit në pika të shkurtra ku nga ekipi monitorues do të prezantohen të arriturat e komunave, ngecjet dhe veprimet të cilat janë në kohë sipas afateve të parapara nga PVPE 2011, sipas mundësisë dhe financimit nga donatoret diskutimi i raportit dhe vlerësimit të implementimit të PVPE 2011 nga komunat të bëhet në një punëtori 3 ditore me zyrtarët përgjegjës të komunave në fjalë.

Pas prezantimi të punës që do të bënë rrjetit OJQ "Qeliza", nga përfaqësuesit tjerë të ftuar janë prezantuar temat që do të diskutohen në trajnimin e datës 15 04 2011 siç janë: Implementimi i Planit të Veprimit për Partneritet Evropian 2011 nga komunat e Republikës së Kosovës dhe Roli i komunave në procesin e bashkëpunimit ndër-komunal dhe bashkëpunimit ndërkufitar.

Pas mbajtjes së këtyre aktiviteteve organizata financuese e këtij projekti (FES) me kërkesë të rrjetit të OJQ-ve të grave Qeliza janë pajtuar që nga data 09.09.2011 deri më 11.09.2011 të mbahet edhe një trajnim me 6 komuna tjera siç janë: Peja, Istog, Klinë, Prizren, Dragash dhe Suharekë.

Trajnimi

Trajnimi është mbajtur me datën 15 04 2011 në Gjakovë në lokalin "Çarshia e Jupave" të ftuar dhe pjesëmarrës kanë qenë:

Fatmir Berisha	KK Gjakovë
Bashkim Krasniqi	KK Malishevë
Nezir Balaj	KK Deçan
Zoje Sejfijaj	KK Deçan
Bashkim Kurti	KK Gjakovë
Hysen Imeri	KK Junik

Beqë Gacaferi	KK Junik
Saban Pejcinovic	KK Deçan
Florije Zhubi	KK Gjakovë
Habibe Haxhimustafa	KK Rahovec
Urim Fazlija	KK Gjakovë
Besnik Shala	KK Gjakovë
Drita Hasimja	KK Gjakovë
Lumnije Shllaku	KK Gjakovë
Florije Zhubi	KK Gjakovë
Emine Islomaj	KK Deçan
Bjondina Rama	KK Rahovec
Iliriana Pylla	TV Syri
Gazmend Doli	Koha Ditore
Qendresa Doli	TV Syri
Lave Lajqi	OSCE
Ricardo Cava	OSCE

Gjatë trajnimit nga prezantuesit kanë trajtuar këto tema:

1. Procesi i Integrimeve Europiane dhe ndërlidhja e Kosovës në këtë proces, duke filluar nga historiku i Bashkimit Evropian dhe hapat që i ka marr Kosova deri tani në fushën e Integrimeve Evropiane ku përfshihet Dialogu i Stabilizim Asocimit, grupet punuese për Integrime Evropiane;

2. Prezantimi i Planit të Veprimit për Partneritet Europian është prezantuar PVPE 2011, konkretisht Prioritetet dhe veprimet e aprovuara, veprimet që janë obligative për komunat fushat dhe Drejtoritë konkrete që i prekin në komunë, rolin e komunave në këtë proces dhe format e raportimit si dhe mënyra e raportimit;

3. Roli dhe rëndësia e komunave në procesin e Bashkëpunimit Ndër-komunal në Kosovë është prezantuar se ku ndodhet Kosova në këtë fazë, programet e bashkëpunimit ndërkufitar, ndarja e zonave për bashkëpunim ndërkufitar dhe kush ka të drejtë të aplikojë në programet për bashkëpunim ndërkufitar;
4. Roli i Komunave në Procesin e Ri-integrimit dhe Ri-atdhesimit, obligimet dhe veprimet konkrete të Planit të Veprimit për partneritet Evropian që prekin këtë fushë, rolin e komunave në këtë proces si kriteret për përfitim nga fondi për riatdhesim nga niveli komunal.

Konkluzioni i takimit:

a. Është vendosur që më datën 20.04.2011 të mbahet një punëtori një ditore me një grup prej 7 – 10 persona në mënyrë që të identifikohen prioritetet dhe veprimet që prekin nivelin komunal;
b. Roli i komunave në implementimin e Prioriteteve dhe veprimeve që dalin nga PVPE 2011;
c. Organizimi i trajnimeve të ngjashme në të ardhmen;
d. Roli më aktiv i shoqërisë civile në monitorimin e implementimit të PVPE 2011 nga institucionet përgjegjëse.

Punëtoria 1 ditore / Grupi punues.

Me datën 20 04 2011 është mbajtur punëtoria për identifikimin e prioriteteve dhe veprimeve që dalin nga PVPE 2011 për nivelin lokal ku pjesëmarrës kanë qenë:

Habibe Haxhimustafa	KK Rahovec
Florije Zhubi	KK Gjakovë
Beqë Gacaferi	KK Junik
Hysen Imeri	KK Junik
Bashkim Kurti	KK Gjakovë
Zoje Sejfijaj	KK Deçan
Nezir Balaj	KK Deçan
Bashkim Krasniqi	KK Malishevë
Fatmir Berisha	KK Gjakovë

Gjatë punëtorisë janë realizuar këto aktivitete:

a. Është përgatitur një draft matricë me prioritetet dhe veprimet që ju përkasin komunave;
b. Është bërë ndarja për secilin veprim të PVPE 2011, dhe është qartësuar se cila Drejtori apo zyre në komunë është përgjegjëse për realizimin dhe implementimin e atij veprimi;
c. Identifikimi i veprimeve që duhet realizuar deri në fundin e Qershorit 2011 sipas afatit K2 – 2011 të PVPE –së.

Punëtoria në Shqipëri

Me datën 17, 18, 19 Qershor është mbajtur punëtoria për unifikimin e raporteve të PVPE-së nga Komunat përfituese për nivelin lokal ku pjesëmarrës kanë qenë:

Hysen Ymeri	Zyrtar për Zhvillim Ekonomik	KK Junik
Beqë Gacaferri	Zyrtar për Integrime Europiane	KK Junik
Ali Tahirsylaj	Zyrtar Komunal për Administratë	KK Deçan
Nezir Balaj	Zyrtar Komunal për Komunitete	KK Deçan
Bashkim Krasniqi	Zyrtar për Integrime Europiane	KK Malishevë
Habibe Haxhimustafa	Zyrtare për Integrime Europiane	KK Rahovec
Florije Boshnjaku	Drejtore për Shëndetësi dhe Mir. Sociale	KK Rahovec
Bashkim Kurti	Zyrtar për Komunitete dhe OJQ	KK Gjakovë
Fatmir Berisha	Zyrtar për Integrime Europiane	KK Gjakovë
Florije Zhubi	Zyrtare për Komunitete	KK Gjakovë

Gjatë punëtorisë janë rishikuar aktivitetet dhe veprimet e realizuara gjer më tani:

Ekipi monitorues gjatë kësaj kohe është fokusuar në këtë formë:

1. Matrica për raportim iu është dërguar komunave përfituese për të raportuar se cilat veprime i kanë realizuar apo përfunduar, cilat janë në proces dhe cilat veprime do të mbesin sfidë e parealizueshme.
2. Në kuadër të këtyre Raporteve ekipi monitorues ka pasur një pasqyrë të qartë se cilat veprime janë realizuar.
3. Si ekip monitorues iu është asistuar komunave përfituese (duke shkuar personalisht në komuna) në plotësimin e matricave dhe inputeve të cilat i kanë plotësuar,
4. Pas mbledhjes së këtyre raportimeve dhe analizave nëse eventualisht mungon ndonjë informatë ekipi monitorues do të kërkoj informata shtesë të cilat dëshmojnë që veprimet konkrete në kuadër të PVPE 2011 janë kryer.
5. Pas mbledhjes së raportimeve ekipi monitorues do të përgatis raportin përfundimtar për mbarëvajtjen e të gjithë projektit dhe për monitorimin e PVPE-së në Komunat përfituese.

Trajnimi me komunat shtesë

Prej datës 09.09.2011 deri më 11.09.2011 është mbajtur trajnimi dhe punëtoria për identifikimin e prioriteteve dhe veprimeve që dalin nga PVPE 2011 për nivelin lokal ku pjesëmarrës kanë qenë:

Shyqyri Kuçi	ZKKK	Suharekë
Kymete Bajraktari	ZKIE	Suharekë
Habibe Bytyqi	ZBGJ	Suharekë
Have Thaçi	ZKIE	Klinë
Grishe Gashi	ShSh	Klinë
Remzije Maloku	ZBGJ	Klinë
Sevdije Ismaili	ZKK	Klinë
Rrust Kabashi	ZKK	Klinë
Sanije Mavraj	NJKDNJBGJ	Istog
Zekije Sutaj	KL	Istog
Rasim Mamutoviq	OKZP	Istog
Kamber Boqolli	ZKIE	Pejë
Pandeli Rugova	SHL	Pejë
Mehmet Hamza	OKZE	Dragash
Uzair Hamza	ZKIE	Dragash

Edhe pse ftesa iu është dërguar Zyrtarëve nga Komuna e Prizrenit, por këta të fundit nuk kanë marr pjesë në trajnim.

Raportimi i matricës së PVPE-së për Komunat Përfituese

Gjakova

Gjatë takimeve dhe raportimeve që i ka bërë zyrtari komunal për Integrime Europiane Z. Berisha – ai na ka treguar për procesin e implementimit të PVPE-së në Komunën e Gjakovës dhe na ka treguar si iu është kërkuar Drejtorëve të Drejtorive që të bashkëpunojnë në mënyrë që të vihet më lehte deri tek informacionet për përmbushjen e veprimeve të PVPE-së, ose të caktojnë ndonjë zyrtar.

Gjatë këtyre takimeve Z. Berisha na njoftoi që Strategjitë për Planet e Arsimit janë në procedurën e Hartimit dhe së shpejti Kuvendi Komunal i Gjakovës do ti ketë dhe do ti implementoj .

Dokumentacioni i cili kërkohet në dy gjuhët për përdorim të komuniteteve jo Shqiptarë për momentin aplikohet me arsyetim se nuk e kemi ndonjë kërkesë për marrjen e këtyre dokumenteve në ndonjë gjuhë tjetër përveç gjuhës shqipe, pra për këtë arsye kemi një vakum sepse nuk kemi zyrtar – përkthyes, por shpresojmë që së shpejti do të rregullohet kjo çështje.

Veprimet e kryera

Në Kuvendin Komunal të Gjakovës është e formuar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) dhe mbahen me rregull takimet e këtij Këshilli ku diskutohen çështjet e sigurisë për komunën e Gjakovës.

Në sektorin e burimeve njerëzore – është themeluar njësiti – raportohet çdo 3 muaj, nga komunitetet i kemi 4 të punësuar nga komunitetet.

Rregullorja për përdorimin e gjuhëve zyrtare është miratuar dhe funksionon prej vitit 2009.

Zyra për komunitet dhe kthim është funksionale dhe kryen punën e saj të përditshme.

Komuna e ka Zyrtarin për Komunitete i cili merret me problemet e përditshme të komuniteteve jo shumicë.

Komuna e ka stafin për Projektet dhe bashkëpunimin ndërkufitar dhe presim që së shpejti të aplikojmë për grantet të cilat janë të parapara për këtë fushë.

Zyra e prokurimit krijon hapësirë për veprim dhe është transparente për të gjithë ata që kërkojnë informacione .

Deçani

Sipas zyrtarëve të Komunës së Deçanit gjatë takimeve dhe raportimeve ata i kanë cekur se në këtë komunë i kemi specifikat pothuajse të ngjashme me komunat tjera.

Problem për Komunën e Deçanit është ende problem Inspektori i pylltarisë – ku është cekur që ka vështirësi në kuadër të veprimeve të cilat janë të paraqitura nga PVPE-ja për këtë fushë.

Veprimet e kryera

Tek çështjet e Riatdhesimit i kemi 4 raste si komunë dhe kemi probleme se nuk kemi se ku ti vendosim personat e rikthyer.

Kontesti për Kanalizimin është pengese e madhe për aplikime në fondet e Komisionit Europian.

Komuna e ka krijuar qendrën për regjistrimin e bizneseve në kuadër të decentralizimit nga niveli qendror për ofrimin e këtyre shërbimeve për qytetarët e Komunës së Deçanit.

Junik

Gjatë takimeve me zyrtarët komunal ata e kanë potencuar që Kuvendi Komunal i Junikut është kryesisht Komunë e re e formuar në fillim si pilot njësi komunale dhe siç dihet kemi mangësi në shumë fusha dhe presim ndihmën si nga niveli qendror po ashtu edhe nga organizatat e ndryshme që veprojnë në komunën tonë.

Regjistrimi i Bizneseve nuk bëhet ende në Junik por bëhet në Prishtinë dhe paraqet problem për Inspektorët.

Vështirësi kemi në mungesën e inspektorëve ku një inspektor i mbulon shumë fusha, kjo ka rrjedhë si mungesë e financave/buxhetit komunal për të rekrutuar punëtorë më shumë.

Problem është ende Pylltaria në komunën tonë.

Ekziston ende problemi me menaxhimin e mbeturinave, në komunën tonë vepron kompania për pastrimin e mbeturinave nga Deçani dhe mbledhja e tyre nuk bëhet me rregull.

Shtrati i lumit Ereniku ende degradohet me marrjen e zhavorrit, ne si komunë mungojmë në kompetencë për ndalimin e operatorëve ilegal të cilët operojnë në komunën tonë.

Zyrtaret për Integrime Europiane e kemi por me herët e kemi pasur problem se janë

ndërruar shpesh këta zyrtar dhe ka pasur problem në ndjekjen e veprimeve dhe bashkëpunimit si me nivelin qendror po ashtu edhe me organizatat e ndryshme të cilat veprojnë në këtë fushë.

Veprimet e kryera

E kemi të miratuar Rregulloren për gjuhët dhe është funksionale.

Rahovec

Komuna e Rahovecit ka një qeverisje të re, është një përparësi se është një staf i ri i cili e njeh teknologjinë dhe mënyrat bashkëkohore të komunikimit.

Në komunën e Rahovecit do të punohet me secilin drejtor që t`iu sqarohen veprimet e tyre të cilat dalin nga PVPE-ja për vitin 2011.

Në komunën e Rahovecit pengesë është Riatdhesimi, a ekziston mundësia që Komuna jonë të ketë një banesë kolektive për personat e rikthyer dhe a financohet kjo iniciativë nga niveli qendror apo nga ndonjë organizate donatore?

Shërbimet Sociale, tek kjo fushë për momentin janë bartur vetëm obligimet e padrejta, si mund të punojmë me këto organizata jo qeveritare kur nuk e kemi buxhetin adekuat për veprim.

Menaxhimi i Mbeturinave Mjekësore është sfide shumë e madhe, ne si komunë nuk e kemi të rregulluar se si do të bëhet menaxhimi i këtyre mbeturinave ku ky veprim ka sfida buxhetore të cilat nuk janë të definuara.

Veprimet e kryera

Në Rahovec e kemi të formuar KKSB-në.

Do të ishte mirë që zyrtarët për Integrime Europiane të jenë të pranishëm në mbledhjet e KKSB-ve në mënyrë që të jenë sa më të informuar.

Malisheva

Kemi raste kur tek ne vijnë individ që i kërkojnë dokumentacionin në dy gjuhët dhe ky dikaster funksionon në komunën tonë.
Ne si Kuvend Komunal i Malishevës i kemi pasur deri më tani 6 raste të rikthimit.

Kemi shumë pengesa por shumica e tyre ndërlidhen me mungesën e Buxhetit në lidhje me implementimin e shumë veprimeve.

Problem tjetër është çështja e gurëthyesve, ata operatorë vijnë në komunë me pëlqimin e ministrisë, e i njëjti problem e kemi edhe me pompat e benzinës.

Privatizimi i tokave është problem se dalin se tokat shoqërore kanë qenë prona private dhe ka konteste.

Problem në fushën e shëndetësisë Epidemia e rriqrave ka filluar dhe do të duhej që niveli qendror të ndërmarr diç për këtë fushë.

Kemi mungesë të subvencioneve për zhvillimin e agrikulturës, Ministria i ndan fondet por ato nuk janë transparente, dhe kërkojmë që e gjithë procedura të jetë më transparente.

Peja

Gjatë takimit me Zyrtarin Komunal për Integrime Europiane Z. Kamber Boqolli nga Komuna e Pejës, ai na njoftoi me të arriturat e kësaj komune, se ku i kanë përmbushur veprimet e dala nga PVPE-ja 2011 e ku kanë pasur ngecje.

Për veprimet e kryera nga Kuvendi Komunal i Pejës është raportuar se Rregullorja Komunale për përdorimin e gjuhëve zyrtare është e miratuar në dhjetor të vitit 2008 dhe ajo aplikohet në punët e përditshme të Kuvendit Komunal.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar Komuna e Pejës ka pasur disa takime me përfaqësuesit e Republikës së Malit të Zi, dhe janë identifikuar disa projekte të fushave të ndryshme të cilat janë përgatitur të cilat presin momentin e aprovimit që të implementohen.

Kuvendi Komunal i Pejës e ka përgatitur stafin për menaxhimin e fondeve të cilat kanë të bëjnë me projekte ndërkufitare.

Në përmbushjen e kërkesave të dala nga Zyra e Kryeministrit për administratën komunale janë të punësuar 19 shërbyes civil të komuniteteve pakicë. Gjithashtu Kuvendi Komunal organizon dhe ofron kurse shërbyesve civil për përmirësimin e dygjuhësisë.

Në përfshirjen e grupeve të margjinalizuara, grave, bashkësive jo-shumicë, dhe personave të riatdhesuar, në aktivitet e zhvillimit ekonomik, Kuvendi Komunal i Pejës nuk ka pasur ndonjë aktivitet në këtë fushë dhe nuk ka të dhëna për ndonjë gjë të tillë.

Në kuadër të marrjes së masave për të parandaluar dëmtimin e pyjeve/maleve dhe tokave në male si rezultat i gurëthyesve, për Komunën e Pejës ende ekziston paqartësi në mosdefinimin e kompetencave në mes të nivelit lokal dhe atij qendror, përkatësisht AKP-së, (Agjencisë Kosovare për Pyje) ?

Në kuadër te kërkesave të dala nga miratimi i legjislacionit shtetëror Komuna e Pejës ka planin e menaxhimit të mbeturinave I cili është në veprim dhe punohet për përmbushjen e tij.

Monitorimi i qasjes së barabarte në shërbimet publike për të gjitha bashkësitë, duke bere ndarjen e të dhënave në lidhje shfrytëzuesit e këtyre shërbimeve, bazuar në etni, gjini, duke siguruar se shërbimet publike janë të pranishme në të gjitha gjuhët zyrtare dhe kanë qasje të barabartë në të gjitha institucionet shëndetësore dhe trajnohen njëjtë sikurse të gjithë qytetaret e Komunës së Pejës si dhe komunikimi iu ipet në gjuhën e tyre amtare.

Sa i përket shërbimeve shëndetësore dhe sociale ata kanë qasje në të gjitha institucionet dhe kanë dhe trajtohen profesionalisht, kurse sa i përket strehimit ne si komunë nuk kemi mundësi ti strehojmë pasi që nuk kemi ndërtesa banimi ku mund ti strehojmë të riatdhesuarit.

Në vazhdën e aktiviteteve për të ndritur vëmendjen/informimin se si ti qasen asistencës sociale veçanërisht grupet e cenuara siç janë të kthyerit dhe komuniteti jo shumice kuvendi Komunal i Pejës ka aktivitete të mjaftueshme si për komunitetin shumicë ashtu edhe për atë pakicë me qëllim të njoftimit përmes formave të ndryshme me kriteret për përfitimin e asistencës sociale.

Kuvendi Komunal i Pejës ka bërë punësimin e stafit për ligjërim dhe stafit akademik për gjuhën boshnjake ku edhe vijohet mësimi, kurse ka përpjekje qe mësimi plotësues të bëhet edhe ne gjuhën rome.

Klina – probleme me te rikthyerit per shkak te procedurave

Gjate takimeve të cilat i kemi pasur me Zyrtaren për Integrime Komunale të Kuvendit Komunal të Klinës Znj. Have Thaqi ajo ka raportuar për përmbushjen e veprimeve të cilat kanë dalë nga PVPE-ja 2011.

Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/2010 është zbatuar në tërësi. Është implementuar Vendimi për riemërtimin dhe organizimin e ZKK. Në Shërbimin Civil në Komunën e Klinës janë të punësuar pesë (5) shërbyes civil nga radhët e komuniteteve pakicë.

Rregullorja Komunale për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Institucione (01-07-72/07 është miratuar më 27.04.2007. Me Rregulloren Komunale, në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve rregullohen kushtet për përdorimin e barabartë të gjuhëve dhe shkrimeve si dhe sigurohet zbatimi i barabartë i tyre në Institucionet Komunale.

Për arsye të vonesave në fazën e zgjedhjeve ka ndodhur edhe vonesa në themelimin e Grupit Punues Komunal për kthim. Si pasojë e kësaj gjendjeje nuk është arritur që të punohet Strategjia Komunale për kthim për vitin 2011. Zyra për Komunitete dhe Kthim

aktivitetet e veta i mbështetë në Strategjinë për kthim 2009-2013 (të Qeverisë së Kosovës); Strategjinë e veprimit për kthimin e serbëve 2011-2013; dhe Strategjinë e Veprimit për kthimin e komunitetit RAE 2009-2011. Zyra për Komunitete dhe Kthim me fokus të veçantë është duke e zbatuar Strategjinë për ri-integrim duke ndihmuar që personat e riatdhesuar të ri-integrohen.

Në ZKK veprohet në bazë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për personat e riatdhesuar. Me marrjen e informatave nga MPB dhe Zyra pranë Aeroportit si dhe me paraqitjen personale të personave të riatdhesuar Zyrtari gjegjës kontakton me personat, i evidenton në regjistrin e formuar pran ZKK, i udhëzon, i njofton me të drejtat e tyre si dhe plotëson kërkesën (e specifikuar me nevojat e personit në fjalë) e cila dërgohet në MPB. Deri më tani ne si Kuvend Komunal i Klinës nuk kemi ndonjë kërkesë të realizuar.

Shefi i Personelit (Burimeve Njerëzore) detyrat nga fushëveprimi i burimeve njerëzore i ushtron në bazë të Rregulloreve: 02/10- Rregullorja mbi regrutimin; 04/10-Rregullorja mbi përfaqësim të drejt dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë; 06/11 -Rregullorja për pushimin e nëpunësve civil; 02/10- Rregullorja për Zyrën Komunale për komunitete dhe kthim; 03/10- rregullorja për përshkrimin e detyrave të punës; 05/10 Rregullorja për orarin e punës; 07/10-Rregullorja për emërimin e nëpunësve civil (aplikohen formularët për regrutim-punësim); 06/10- Rregullorja për transferimin e nëpunësve civil.

Zbatimin e tërësishëm të rekomandimeve të Zyrës se Kryeministrit për përfaqësim proporcional të bashkësive jo-shumicë në shërbimin civil - Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/2010 është zbatuar në tërësi. Është implementuar Vendimi për riemërtimin dhe organizimin e ZKK . Si dhe Rregullores Nr.04/2010, për Procedurat e Përfaqësimit të Drejtë dhe Proporcional të Komuniteteve jo shumicë në shoqërinë civile në Kosovë. Në Shërbimin Civil në Komunën e Klinës janë të punësuar pesë (5) shërbyes civil nga radhët e komuniteteve pakicë.

Në kuadër të marrjes së masave për të parandaluar dëmtimin e pyjeve/maleve dhe tokave në male si rezultat i gurëthyesve - Hapja e bizneseve të Gurëthyesve i nënshtrohet procedurës: së pari të interesuarit duhet të pajisen me licencë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM). Departamenti i Minierave në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik ndër të tjera ka këto detyra dhe përgjegjësi: Promovon veprimtari që kanë për qëllim zvogëlimin e ndotjes së mjedisit si rezultat i veprimtarive që lidhen sektorin minerar; Monitoron lëshimin e licencave dhe lejeve për veprimtarinë minerare të Kosovë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM Bashkëpunon dhe mbështet krijimin e ambientit të përshtatshëm për investime private në sektorin minerar; Përgatit planin për

zhvillimin dhe participimin e komuniteteve (popullatës) të ndikuar nga punimet minerare; Mbikqyjen e biznesit të gurëthyesve në Komunën e Klinës e bënë Inspektorati i Minierave dhe mineraleve me Zyrën në Klinë.

Shërbimet shëndetësore të cilat ofrohen në institucionet shëndetësore Komunale kanë qasje të barabartë të gjithë banorët pa dallim etnie, gjinie etj. Në qendrën për Punë Sociale aktualisht janë shfrytëzues të ndihmave: 1128 shqiptar; 28 ashkali; 13 rom; 3 serb dhe 2 të tjerë.
Deri më tani nuk kemi pasur evidencë/kërkesa të veçantë për të riatdhesuarit, por qasja në shërbime shëndetësore dhe shërbime të tjera në Institucionet Komunale u është mundësuar të gjithë banorëve pa dallim.

Infrastruktura shkollore në Komunën e Klinës mundëson qasje të mirë në sistemin shkollor si atë fillor po ashtu edhe në atë të mesëm. Është në përfundim e sipër objekti i shkollës së mesme teknike i cili do të mundësoj një qasje edhe më të avancuar në sistemin e shkollimit. Nga 17 shkolla fillore amë, në 8 sosh shkollimin e ndjekin edhe nxënës të komunitetit RAE (në SHF. në Budisalc 40% e nxënësve janë të komunitetit RAE). Në vitin e kaluar shkollor, shkollimin e kanë ndjekur 281 nxënës të komunitetit RAE.

Istog – procedurat per te rikthyerit nuk jane te qarta

Në takimet me zyrtarët Komunal të Kuvendit Komunal të Istogut, ata kanë raportuar për aktivitetet e përmbushura dhe vështirësitë në përmbushjen e PVPE-së 2011.

Nga 143 shërbyes civil në administratën komunale, prej tyre 16 janë nga komuniteti jo-shumicë, ndërkaq, në arsim nga 627 punëtorë, 17 janë minoritarë dhe në shëndetësi janë 2 pjesëtarë të komunitetit jo shumicë nga gjithsej 121 punëtorë. Në Gjykatën Komunale nuk ka asnjë të punësuar nga komuniteti jo-shumicë.

Strategjia për Kthim nuk është hartuar në këtë vit për arsye se nuk ka Grup Punues Komunal (GPK) pasi që tani zbatohen Koncept Dokumente (kthimi i organizuar me koncept dokument). Tani sipas Manualit më të ri për kthim, nuk ka kthim të organizuar por ka vetëm kthim individual. Lidhur me këtë, ne si Komunë kemi një "Task-Force" e cila e zëvendëson GPK ku marrin pjesë të gjithë akteret relevant lidhur me kthimin. Janë mbajtur 3 Vizita "Shko dhe Vizito" për RAE 2 dhe për komunitetin Serb 1. Të kthyer nga vendet e treta, në mënyrë vullnetare, janë 17 persona prej datës 01.01.2011 deri me 01.06.2011. Persona të zhvendosur dhe të kthyer të komunitetit serb nga Serbia 7. Për Komunitetin RAE, janë mbajtur dy aktivitete në Durrës -Shqipëri me moton " Shkolla verore multietnike dhe tradicionale". Aktiviteti "Lojërat e paqes" të organizuara në Shtëpinë e kulturës

"Adem Jashari" në ISTOG nga OJQ "Vizion 02". Lidhur me riatdhesimin, janë mbajtur 2 trajnime nga MPB -ja për stafin e ZKKK -së.

Në komunën tonë KKSB-ja vepron në vazhdimësi dhe në këtë këshill janë përfaqësues te komuniteteve që jetojnë në komunë, përfaqësues te komuniteteve fetare (nga besimi islam, katolik dhe ortodoks) përfaqësues nga KFOR-i, Policia e Kosovës, FSK, Burgu i Dubravës, Pylltaria, Shoqëria civile, etj. Mbledhjet e kësaj trupe janë mujore dhe në to ngritën çështje të rëndësishme nga fusha e sigurisë por edhe nga lami tjera. KKSB ka aprovuar edhe planin vjetor të punës.

Në kuadër të marrjes së masave për të parandaluar dëmtimin e pyjeve/maleve dhe tokave në male si rezultat i gurëthyesve. Duke u bazuar në Ligjin e ri për Pyjet e Kosovës dhe me kalimin e kompetencave nga niveli qendror në atë lokal, parashihet vetëm mbrojtja e pyjeve por menaxhimi edhe me tutje mbetet kompetence e nivelit qendror. Sa i takon pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura, në bashkëpunim me APK-në (Agjensioni i Pyjeve të Kosovës) dhe Zyrën Komunale të Punësimit, çdo vit pyllëzojmë sipërfaqe të caktuara. Këtë vit do të pyllëzojmë një sipërfaqe prej 10 ha. Duhet thënë se prerjet ilegale kanë rënë për rreth 60 % nga momenti i kalimit të kësaj përgjegjësie tek komunat.

Të ri atdhesuarit ne Komunën e Istogut në rast mungese të strehimit, ZKKK përkujdeset për sigurimin e strehimit të tyre, qoftë duke përdorur banesa private apo edhe duke shfrytëzuar banesa shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e AKP-së por që shpenzimet e banimit të tyre do të mbulohen nga fondi i qeverisë, respektivisht MPB-së. Ndërkaq, personat e riatdhesuar kanë qasje në të gjitha shërbimet Shëndetësore në kuadër të Kujdesit Primarë Shëndetësorë.

Kuvendi Komunal i Istogut ne vazhdën e aktiviteteve për të ngritur vëmendjen/informimin se si të qasen asistencën sociale veçanërisht grupet e cenuara siç janë të kthyerit dhe komuniteti jo-shumicë. Komuna jone sipas nevojës, organizohen takime me karakter informimi siç ishte në pjesën e parë te këtij viti në Llukafc të Thatë me të kthyerit e Komunitetit RAE. Ndërkaq, kushdo qe paraqitet në Qendër për Punë Sociale, ata informohen rreth kritereve te përcaktuara me ligj për të gëzuar asistence sociale duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë.

Në kuadër të Punësimit të stafit për ligjërim dhe stafit akademik në gjuhën Rome dhe gjuhët tjera të bashkësive në komunën tonë nxënësit romë janë të bashkëngjitur me nxënësit shqiptarë. E dëgjojnë ligjërimin shqip sepse nuk kanë pengesa në gjuhë. Pothuajse e kanë edhe gjuhë amtare që e përdorin në familje. Kurse për nxënësit boshnjak është i siguruar kuadri për ligjërim në gjuhën e këtij komuniteti.

Dragash

Gjatë takimeve me Zyrtarin Komunal për Integrime Europiane Z. Hamza, ai ka raportuar se komuna e Dragashit është në këtë gjendje në përmbushjen\mospërmbushjen e veprimeve të kërkuara nga PVPE-ja 2011.

Komuna e Dragashit e ka të formuar dhe të trajnuar Njësitin për të drejtat e njeriut, Njësiti përbëhet nga tre anëtar Shaban Shabani , Lindita Piraj dhe Uzair Hamza - boshnjak-goran.
Përfaqësimi proporcional i bashkësive jo shumicë në shërbimin civil dhe në ndërmarrje shoqërore gjithnjë bëhet duke u bazuar në numrin e qytetarëve sipas regjistrimeve të popullsisë 41.3% minoritarët. Pengesë e realizimit të kësaj të drejte paraqet mungesa e kudrave nga minoritarët.

Rregullorja për përdorimin e gjuhëve zyrtare është miratuar me datën 22.06.2009 me nr.01/90-109 e cila në përpikëri aplikohet pa probleme.

Me vendimin Nr.01/06-967/1 i datës 03.05.2011 i cili është miratuar nga Kuvendi Komunal, Komuna ka bashkuar Zyrën për komunitete me zyrën për kthim dhe kështu ka formuar Zyrën për komunitet dhe kthim. Zyrtarët janë trajnuar nga zyrtarët e MIE-së dhe MAPL-ja dhe janë pajisur me materiale për punë(Fletushka ,broshura të ndryshme dhe CD-ja etj).

Komuna e Dragashit ende nuk e ka të miratuar Strategjinë për Kthim dhe Riintegrim për vitin 2011, por ata punojnë duke u konsultuar me organet qendrore të MIE dhe MAPL , për tejkalimin e problemeve.

Komuna e Dragashit ka të formuar grupin nga Zyrtarët Komunal të civilët janë të trajnuar për projektet me karakter ndërkufitare dhe për mënyrat e aplikimit në këto fonde.

Komuna e Dragashit ende nuk e ka bërë përshkrimin e detyrave të stafit punues. Por punojmë sipas një sistematizimi të miratuar në vitet e mëhershme.

Komuna e Dragashit në tërësi i zbaton rekomandimet e Zyrës së Kryeministrit për përfaqësim proporcional 41.3% minoritar sipas regjistrimit të popullsisë.

Në Komunën e Dragashit zyrtarëve Komunal nuk iu është ofruar kurse shërbyesve civil lidhur me përmirësimin e standardit të dygjuhësisë.

Komuna e Dragashit si dobësi të saj e ka përfshirjen e grupeve të margjinalizuara si gratë, bashkësitë jo-shumicë dhe personave të riatdhesuar në aktivitetet që ndikojnë në zhvillimit ekonomik lokal.

Punësimi i stafit për ligjërim dhe stafit akademik në gjuhën Rome dhe gjuhët tjera të bashkësive – Në përmbushjen e veprimeve ne fushën e arsimit Komuna e Dragashit ka të

punësuar vetëm ligjërues në gjuhën boshnjake dhe atë një numër të vogël të cilët kanë përkrahur Plan-Programin e shtetit të Kosovës.

Kurse si kërkesë e zyrtarit komunal për Integrime Europiane ka dalë që Qeveria e Kosovës të investoj më shumë në këtë komunë në mënyrë që të përmirësohet dhe të rritet kualiteti i jetës së qytetarëve të kësaj komune.

Suharekë

Në kuadër të aktiviteteve të monitorimit për përmbushjen e PVPE-se 2011 në komunën e Suharekës janë organizuar takime me Znj. Kymete Bajraktari dhe me zyrtarë të tjerë të kësaj komune.

Në shërbimin civil të komunës së Suharekës janë të punësuar tre persona të komunitetit jo shumicë.

Gjithashtu Komuna e Suharekës ka miratuar strategjinë për kthim dhe ka filluar të zbatohet. Zyrtari për kthim ndihmon në përgatitjen e raporteve vlerësuese, deri me tani janë përgatitur 12 raporte për persona të cilët janë riatdhesuar në komunën tonë.

Pjesëmarrja e bashkësive jo shumice është proporcionale në shërbimin civil sipas kërkesave/dokumenteve të cilat vijnë nga niveli qendror.

Kemi persona të riatdhesuar të cilët kanë problem me banim të përshtatshëm për të jetuar, në shërbimet tjera dhe shëndetësi primare kanë qasje.

Punësimi i stafit për ligjërim dhe stafit akademik në gjuhën Rome dhe gjuhët tjera të bashkësive, ne si kuvend komunal nuk kemi kërkesa për te ligjëruar në gjuhet tjera.

Përmbledhje dhe Rekomandime

Ideja e këtij projekti ishte që të bënte një skanim të gjendjes aktuale në fushën e implementimit të PVPE-së në Komunat përfituese të këtij projekti dhe ti ndihmonte ato në përmbushjen e obligimeve komunale që dalin nga ky dokument. Ne se implementues të këtij projekti besojmë që këto rekomandime janë të aplikueshme dhe do të përmirësoj procesin e raportimit të PVPE-së në nivelin qendror, dhe ne gjithashtu besojmë që lidershipi komunal do ti merr parasysh rekomandimet e këtij projekti.

Gjithashtu Rrjeti i OJQ-ve të Grave "Qeliza" dëshiron që ti falënderoj të gjitha ata persona të cilat kanë ndihmuar në implementimin e këtij projekti, duke filluar prej zyrtarëve komunal të komunave përfituese, pjesëtarët e Organizatave të ndryshme dhe ekspertët të cilët kanë qenë të involvuar në mënyrë direkte apo indirekte në implementimin e këtij projekti.

Gjatë periudhës së raportimit për Projektin e "Integrimet e Unionit Europian në Nivelin Lokal", ekipi monitorues ka arritur që ti nxjerr disa rekomandime dhe kërkesa të cilat zyrtarët komunal për integrime europiane i kanë paraqitur gjatë takimeve të përbashkëta të cilat i kemi pasur gjatë periudhës së raportimit.
Rekomandime:

- Të forcohet pozita e zyrtareve për integrime Europiane në Komuna;
- Te forcohet bashkëpunimi në mes të zyrtarëve për integrime europiane dhe Drejtorëve të Drejtorive dhe Kryetarit për Raportimin sa me adekuat të arritjeve për përmbushjen e veprimeve të PVPE-së;
- Të ketë punëtori të cilat do të forconin pozitën, nivelin e njohurive, dhe ngritjen e kapaciteteve për Zyrtarët Komunal për Integrime Europiane për të gjitha Komunat e Kosovës
- Të ftohen Zyrtarët për Integrime Europiane në takime me Organizata/institucione Ndërkombëtare dhe të ju krijohen mundës që Zyrtarët për Integrime Europiane të jenë kontakti i parë për Organizatat/Institucionet që vijnë në komunë për të diskutuar çështje të ndryshme me interes të qytetareve/komunës
- Shoqëria Civile të ketë rol më aktiv në monitorimin e implementimit të PVPE 2011 nga institucionet përgjegjëse.

Botues: **Friedrich-Ebert-Stiftung**

Friedrich-Ebert-Stiftung Zyra në Prishtinë, Kosovë
Rr.Mujo Ulqinaku 4/App 10
Tel: +381 38 601 900, 601 901
Fax: +381 38 601 902
Email: contact@fes-prishtina.org
www.fes-prishtina.org

Radhitja: **Studio FORMA**

Shtypi: **Studio FORMA**

Dizajni i Kopertinës: **Lulzim Bunjaku**

Data e shtypit: Tetor 2011

Vendi: Prishtinë

Copyright Friedrich-Ebert-Stiftung